



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2646/3 prot.

Datë, 02.11.2023

V E N D I M
Nr.1118/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.11.2023 shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-84407-10-19-2023 me objekt “Shpenzime për blerje pajisje profesionale që iu shërbejnë strukturave të MZSH”, me fond limit 8,323,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Korçë
- Ankimues:** “Mbrotjtja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK me NIPT L62102007V dhe adresë: Gurten SHPK, Rruga e Kavajës, Nr.116, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Korçë me adresë: Bulevardi Shën Gjergji, L.12, Korçë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 24 e vijues Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.

596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.10.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-84407-10-19-2023 me objekt “Shpenzime për blerje pajisje profesionale që iu shërbejnë strukturave të MZSH”, me fond limit 8,323,000.00

lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar me datë 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Korçë.

II.2. Në datën 27.10.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3545, protokolluar me nr. 2646/2023 prot., datë 30.10.2023, e operatorit ekonomik "Mbrotjtja dhe shpëtimi nga zjarri" SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4 Me shkresën nr. 8635/3 prot., datë 31.10.2023, të dërguar në KPP përmes komunikimit elektronik zyrtar dhe protokolluar me tonën me nr.2646/2 prot., datë 02.11.2023, me objekt "Dërgim informacioni" është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku zyrtari i autorizuar për shqyrtimin e ankesës me vendimin nr. 8635/1 prot., datë 31.10.2023 ka vendosur refuzimin e ankesës, konkretisht duke u shprehur: "Mbasi shqyrtova ankesën, pretendimet e ankuesit dhe dokumentacionin e ndodhur në dosjen e tenderit arsyetova si më poshtë vijon:

I. Autoriteti kontraktor ka shpallur në datën 20.10.2023 procedurën e prokurimit me objekt "Shpenzime për blerje pajisje profesionale që ju shërbejnë strukturave të MZSH" REF-84407-10-19-2023, e parashikuar për tu zhvilluar në datën 30.10.2023.

II. Në datën 30.10.2023 ka dorëzuar ankesë elektronikisht shoqëria "MBROJTJA DHE SHPËTIMI NGA ZJARRI" sh.p.k, NIPT L62102007V.

III. Në nenin 96 pika 3 të VKM Nr. 285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Nëse autoriteti/enti kontraktor konstaton se, ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me nenin 110, të LPP-së, e refuzon atë, si të pavlefshme."

Në nenin 110, pikat 1, 7 dhe 8 "Afatet për ankimim" i ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikon shprehimisht se: "1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në rastin konkret, rezulton, se publikimi i njoftimit të kontratës është kryer në datën 20.10.2023 ndërkohë ankesa e operatorit ekonomik ankimues është paraqitur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, në datën 30.10.2023, administruar nga KPP me numër ankimi elektronik A/2023/3545 dhe me nr. 2646/2023 prot datë 30.10.2023, dhe protokolluar nga autoriteti kontraktor me Nr 8635 Prot date 30.10.2023, jashtë afatit 7 ditor të përcaktuar në ligj.

Sa më sipër, gjykoj se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës .

Për sa më sipër bazuar në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” neni 114 dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 102.

VENDOSA:

Të refuzoj ankesën e paraqitur nga Shoqëria “MBROJTJA DHE SHPËTIMI NGA ZJARRI sh.p.k, NIPT L62102007V, për procedurën e prokurimit me objekt: Shpenzime për blerje pajisje profesionale që ju shërbejnë strukturave të MZSH” REF-84407-10-19-2023.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues dhe dokumentacionit provues dorëzuar nga ky i fundit, si dhe nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në datën 20.10.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-84407-10-19-2023, me objekt “Shpenzime për blerje pajisje profesionale që iu shërbejnë strukturave të MZSH”, me fond limit 8,323,000.00

lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 30.10.2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Korçë.

III.1.1. Në datën 27.10.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3545, protokolluar me nr. 2646/2023 prot., datë 30.10.2023, e operatorit ekonomik “Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

III.1.2. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

III.1.3. Me shkresën nr. 8635/3 prot., datë 31.10.2023, të dërguar në KPP përmes komunikimit elektronik zyrtar dhe protokolluar me tonën me nr.2646/2 prot., datë 02.11.2023, me objekt “Dërgim informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku zyrtari i autorizuar për shqyrtimin e ankesës me vendimin nr. 8635/1 prot., datë 31.10.2023, ka vendosur refuzimin e ankesës.

III.1.4. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij”.

III.1.5. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.6. Në nenin 110, pikat 1, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.7. Në nenin 111, pika 1 dhe 4 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t’i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.”

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të ligjit 162/2020 parashikon shprehimisht se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik”.

Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të

punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës”.

Neni 115, “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “*Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës”.

Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “*1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.*

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.

III.1.8. Referuar bazës ligjore të sipërcituar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të kontratës (20.10.2023), ka qenë data 26.10.2023. Ndërsa ankesa është paraqitur nga operatori ekonomik ankimes nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik me datë 27.10.2023, pra jashtë afateve të ankimit.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e operatorit ekonomik “Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK, për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, është dorëzuar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 110 pika 1 e LPP, i cili parashikon se: *Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave*

për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të kontratës dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret data e publikimit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është 20.10.2023, ndërkohë ankesa e paraqitur nga ankimuesi nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik mban datën 27.10.2023, jashtë afatit 7 ditor të përcaktuar në ligj, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që ta dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në autoritet kontraktor dhe në KPP, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-84407-10-19-2023 me objekt “Shpenzime për blerje pajisje profesionale që iu shërbejnë strukturave të MZSH”, me fond limit 8,323,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 30.10.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Korçë.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

